Vendim nr. 282, datë 31.07.2026

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Sandër Beci,	Anëtar

në datën 31.07.2026 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 6 (J) 2026 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **JUXHIN GJOSHE,** përfaqësuar nga avokatja Joana Qeleshi, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 857 (302-2023-2584), datë 01.06.2023 të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm; nr. 00-2025-1653 (263), datë 06.11.2025 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm ose në Gjykatën e Lartë.

BAZA LIGJORE: **Nenet 29, 30, 42, 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pika 1, shkronja "i", 141 dhe 142 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 7 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); nenet 71, 71/a dhe 71/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sandër Beci, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese të saj, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 25.06.2016, në "Spitalin Amerikan" Tirana 2 (spitali privat), prindërit e një fëmije të sapoardhur në jetë janë vënë në dijeni se fëmija e tyre ka mungesë të dorës dhe të parakrahut të djathtë deri në afërsi të artikulacionit të bërrylit. Nëna e fëmijës ka qenë e siguruar pranë kompanisë së sigurimeve "Sigal" dhe përkujdesi mjekësor gjatë periudhës së shtatzënisë është bërë në spitalin privat nga ana e mjekut obstetër gjinekolog Juxhin Gjoshe (*kërkuesi*).

2. I ndodhur në këto kushte, babai i fëmijës ka bërë kallëzim penal ndaj kërkuesit për mjekim të pakujdesshëm të bashkëjetueses së tij gjatë shtatzënisë së saj dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë (*Prokuroria e Tiranës*) ka regjistruar procedim penal për veprën penale "Mjekimi i pakujdesshëm", të parashikuar nga neni 96, paragrafi 1, i Kodit Penal (*KP*) në ngarkim të kërkuesit.

3. Gjatë hetimeve, Prokuroria e Tiranës ka sekuestruar dosjen mjekësore të nënës së fëmijës në spitalin privat, në të cilën janë përfshirë dokumentacioni mjekësor që pasqyron ndjekjen e shtatzënisë së saj, analiza dhe ekografitë e saj përfshirë atë morfologjike, që në fillimet e shtatzënisë e deri në lindjen e fëmijës. Pas konstatimit se fëmija ka lindur me mungesë të një të tretës së parakrahut dhe dorës dextra (amputim intrauterine patologjik), si dhe me një lezion me përmasë 3 cm deri në 4 cm pa prekur strukturën muskulore dhe kockore, placenta e ruajtur në formalin është dërguar për ekzaminim histopatologjik, nga ku ka rezultuar se në placentë vërehen formacione të bardha me konsistencë kërcore në terrenin e një Sindrome të Bandave Amniotike (SBA). Nga këqyrja e këtyre ekzaminimeve ka rezultuar se kërkuesi në asnjë moment nuk e ka konstatuar diagnozën e SBA-së, si dhe mungesën e parakrahut dhe të dorës së djathtë. Në këto kushte, Prokuroria e Tiranës ka vendosur kryerjen e një ekspertize mjeko-ligjore, me qëllim përcaktimin e faktit nëse ka qenë e mundur të evidentohej mungesa e parakrahut dhe zhvillimi pa një pjesë të gjymtyrës që në faza të hershme të shtatzënisë, pra në kohën e kryerjes së analizave,

të ekografisë morfologjike, si dhe të analizave të mëtejshme të realizuara gjatë periudhës së shtatzënisë.

4. Në vijim, nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor të fëmijës i datës 13.12.2016, i kryer nga dy mjekë, ka rezultuar se SBA-ja është një çrregullim kongjenital i shkaktuar nga kapja e pjesëve fetale zakonisht e gjymtyrëve dhe gishtave në bandat fibroze amniotike në uterus, nuk është e trashëgueshme, si dhe ekziston mundësia që në faza të ndryshme gjatë ekzaminimit ekografik të evidentohet banda amniotike dhe mund të ndiqet në dinamikë. Po kështu, sipas ekspertizës së tyre në ekzaminimin ekografik mund të evidentohet edhe mungesa e organit, ndaj, në rastin konkret, vërehen elemente të mjekimit të pakujdesshëm, të cilat konsistojnë në mosdiagnostikimin e mungesës së dorës dhe e një pjese të parakrahut të anësisë të sipërme të djathtë, duke sjellë, për pasojë, lindjen e një fëmije me dëmtime shëndetësore të rënda (invalidizuese).

5. Në kuadër të hetimit të kësaj çështjeje dhe në vlerësim të konkluzioneve të pasqyruara në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor, për të cilat ekspertët janë shprehur me "mund" si për përcaktimin e diagnozës, si dhe në vlerësim të kërkesës dhe të dhënave studimore të paraqitura me memo nga kërkuesi i pandehur, Prokuroria e Tiranës ka vendosur riekspertim mjeko-ligjor, duke caktuar një grup ekspertësh të përbërë nga dy specialistë të fushës në spitalin publik, si dhe nga tre mjekë të Institutit të Mjekësisë Ligjore (*IML*).

6. Në vijim, nga aktet e ekspertimit mjeko-ligjor të të dy mjekëve të spitalit publik ka rezultuar se fëmija paraqet mungesë të dorës dhe të parakrahut të djathtë, deri në afërsi të artikulacionit cubiti (bërrylit) dhe shkaku i ardhjes së këtyre dëmtimeve mund të jetë si pasojë e sëmundjes të quajtur SBA, e cila nuk është me origjinë gjenetike. Sipas ekspertëve, në ekografitë e kryera nga fillimi i shtatzënisë deri në javën e 22-të vërehet qartë lëngu amniotik në sasi normale me aspekt normal të pastër dhe në asnjë plan nuk duket prezenca e bandave amniotike të lira, ndërsa deri në javën e 28-të nuk është konstatuar amputim ekstremitetesh dhe në ekografi jepen përmasat e ulnës, si dhe foto të saj. Sipas ekspertëve mjeko-ligjorë, duke gjykuar të dhënat ekografike dhe bazuar në informacionet e dhëna nga literatura, nekroza e gjymtyrës ka ndodhur në gjysmën e dytë të shtatzënisë dhe ngjarja e mirëfilltë e amputimit mund të ketë ndodhur në fillimin e tremujorit të tretë të shtatzënisë. Po kështu, sipas tyre, në rastin konkret janë kryer më shumë ekzaminime ekografike sesa 4 që përmban protokolli i spitaleve publike (bazuar në udhëzimet e Organizatës së Botërore të Shëndetësisë). Trajtimi i SBA-së, sipas ekspertizës mjeko-ligjore, mund të kryhet

jashtë vendit vetëm në pak klinika shumë të specializuara dhe konsiston në prerje të bandave kur fëmija është brenda mitrës ose ndërprerje të shtatzënisë përpara kohe, para se të japë dëmtime fatale.

7. Ndërkohë, referuar aktit të ekspertimit mjeko-ligjor të mjekëve të IML-së, ka rezultuar se ndonëse SBA-ja nuk ka shenja klinike, ekografitë duhet të evidentonin mosrritjen e gjymtyrës deri në mungesën e saj, ndaj mjekut duhet t'i tërhiqte vëmendjen mosrritja e gjymtyrës dhe në rast se kjo patologji do të konstatohej, mund të kryhej jashtë vendit ndërhyrja me lazer-terapi nëpërmjet fetoskopisë. Sipas mjekëve të IML-së, amputimi mund të ketë ndodhur në tremujorin e fundit të shtatzënisë, por duke pasur në konsideratë zhvillimin e kësaj sëmundjeje në kohë, mund të ndërhyhej nëpërmjet operacionit cezarian për lindjen përpara kohe të fëmijës, ndërkohë që në rastin konkret nuk është zbatuar në mënyrë korrekte protokolli i detyrueshëm në ndjekjen e një shtatzënie, konkretisht ka devijim nga protokolli i ekografisë morfologjike për faktin se nuk pasqyrohen matjet e gjymtyrëve të të dyja anësive të sipërme, ndërsa në ekzaminimin e fundit të datës 07.06.2017 (kur shtatzënia ka qenë në javën 32+6 ditë), nuk përshkruhen në asnjë paragraf të dhënat për anësitë e sipërme.

8. Pas kryerjes së veprimeve hetimore, Prokuroria e Tiranës i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me kërkesë për dërgimin për gjykim të kërkuesit dhe deklarimin fajtor të tij, për kryerjen e veprës penale "Mjekimi i pakujdesshëm", të parashikuar nga neni 96, paragrafi 1, i KP-së.

9. Me vendimin nr.1671, datë 04.06.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur: (i) deklarimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprës penale "Mjekimi i pakujdesshëm", të parashikuar nga neni 96, paragrafi 1, i KP-së dhe dënimin e tij me 10 (dhjetë) muaj burgim; (ii) pezullimin e ekzekutimit të dënimit me burgim për një kohë prove prej një viti e tetë muajsh, me kusht që kërkuesi i pandehur gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës, Tiranë, bazuar në nenet 59 dhe 61 të KP-së; (iii) ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë profesionale të kërkuesit si mjek obstetër gjinekolog gjatë kohës së provës, bazuar në nenin 60/5 të KP-së. Sipas gjykatës së shkallës së parë, nga analiza në tërësi e provave të administruara në procedimin penal, duke përfshirë të gjitha aktet e ekspertimit të administruara në dosje në zbatim të vendimit të ekspertimit dhe riekspertimit, ka rezultuar se kërkuesi i pandehur duhej dhe ka pasur mundësi të konstatonte sëmundjen dhe të njoftonte për të

prindërit e fëmijës në mënyrë që ata të vendosnin për sa i përket mundësisë së eliminimit të pasojës së rëndë shëndetësore te fëmija i lindur. Ajo gjykatë ka vlerësuar se për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit për kërkuesin e pandehur, bazuar në nenet 47, 48, 49 të KP-së, ka marrë parasysh shkallën dhe formën e fajit të tij në kryerjen e veprës penale (pakujdesi), rrezikshmërinë shoqërore të kërkuesit, i cili rezultoi të jetë i padënuar sipas vërtetimit të gjendjes gjyqësore, si dhe nevojat e familjes dhe personalitetin e tij. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuesi.

10. Me vendimin nr. 857 (302-2023-2584), datë 01.06.2023, Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, por me ndryshimin që në aplikim të nenit 63 të KP-së të pezullohet ekzekutimit i vendimit me burgim dhe të zëvendësohet me detyrimin e kërkuesit të pandehur të përmbushë një punë në interes publik në masën e 40 orëve punë, si dhe heqjen e dënimit plotësues të parashikuar nga neni 60, pika 5, i KP-së. Sipas gjykatës së apelit, me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arritur në përfundimin se kërkuesi i pandehur ka konsumuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohet dhe se shumica e ekspertëve kanë konkluduar se ai ka qenë i detyruar dhe ka pasur mundësi të evidentojë diagnozën, por ai jo vetëm nuk e ka evidentuar këtë diagnozë, por në mënyrë të pakujdesshme nuk ka konstatuar as mungesën pjesërisht të gjymtyrës së fetusit. Sipas gjykatës së apelit, është pikërisht mungesa e kujdesit që duhet të tregonte kërkuesi i pandehur në ushtrimin e detyrës së mjekut që e ngarkon me përgjegjësi penale. Për sa i përket dënimit të kërkuesit të pandehur, gjykata e apelit ka vlerësuar se rrezikshmëria e tij është e ulët dhe nuk mund të konsiderohet e asaj shkalle që e përjashton atë nga e drejta për të aplikuar dënimin alternativ të parashikuar në nenin 63 të KP-së, pasi gjatë gjithë hetimit dhe gjykimit nuk është evidentuar asnjë rrethanë që do ta klasifikonte kërkuesin e pandehur si të rrezikshëm shoqërisht dhe nuk ka asnjë të dhënë se ka tendenca për të kryer vepra të tjera penale nëse do të lihej i lirë ose nën kushtet e dënimit alternativ. Për më tepër, gjykata e apelit ka vlerësuar se duhet të mbahet në konsideratë edhe parimi i humanizmit i parashikuar në nenin 1/c të KP-së në raport me rrethanat dhe qëllimin ndëshkues e edukues të dënimit penal, duke konkluduar në këtë mënyrë se dënimi me burgim për kërkuesin e pandehur duhet të zëvendësohet me detyrimin që të kryejë 40 orë pune në interes publik, sipas kushteve, vendit të punës dhe orarit të punës që do të përcaktohet nga shërbimin i provës, me të cilin i pandehuri duhet të mbajë kontakte të rregullta deri në përfundim të këtij dënimi. Sipas gjykatës së apelit, aplikimi i alternativës së dënimit të parashikuar nga neni 63 i KP-së për kërkuesin e

pandehur nuk bie ndesh me plotësimin e qëllimit të dënimit (ndëshkimi dhe riedukimi i fajtorit, si dhe efekti parandalues dhe edukues i dënimit për shoqërinë), për sa kohë që gjatë gjithë hetimit dhe gjykimit nuk është evidentuar asnjë rrethanë që do ta klasifikonte atë si person me rrezikshmëri shoqërore në atë masë që izolimi i tij nga shoqëria do të ishte i domosdoshëm. Po kështu, gjykata e apelit ka vlerësuar se aplikimi ndaj kërkuesit të pandehur të dënimit plotësues të ndalimit për të ushtruar veprimtarinë profesionale si mjek obstetër gjinekolog, gjatë kohës së provës, nuk i shërben qëllimit të dënimit në përgjithësi dhe atij të dënimit plotësues në veçanti, ndaj vlerësohet se qëllimi i dënimit, si për sa i përket parandalimit të posaçëm, ashtu edhe atij të përgjithshëm, përmbushet plotësisht edhe me dënimin kryesor të dhënë, pa qenë i nevojshëm aplikimi edhe i dënimit plotësues, pasi kërkuesi i pandehur, pavarësisht veprës së kryer, për të cilën edhe është dënuar, nuk njihet si person me tendenca negative në drejtim të ushtrimit të profesionit si mjek obstetër-gjinekolog, që do të sillte domosdoshmërinë e aplikimit ndaj tij të dënimit plotësues të parashikuar nga neni 60, pika 5, i KP-së. Kundër këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi i pandehur.

11. Me vendimin nr. 00-2025-1653 (263), datë 06.11.2025, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se nga analiza e fakteve ka rezultuar se i gjykuari, në cilësinë e mjekut obstetër-gjinekolog, ka kryer ekzaminime me ultratinguj gjatë shtatzënisë, por pa evidentuar një anomali të rëndë të fetusit, konkretisht amputimin e njërit prej parakrahëve. Sipas Gjykatës së Lartë, në këto kushte, kërkuesi kishte një detyrim profesional të shtuar për të ushtruar kujdesin e kërkuar nga standardet e profesionit të tij, duke qenë se aktiviteti i tij lidhet drejtpërdrejt me shëndetin dhe jetën e njeriut, ndaj mosidentifikimi i një anomalie të tillë përbën shkelje të këtij detyrimi dhe ka sjellë pasoja të rënda për viktimën dhe familjarët e saj. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vepra penale është kryer me faj në formën e pakujdesisë, pasi kërkuesi nuk ka treguar nivelin e kujdesit profesional që kërkohet nga një mjek specialist në rrethana të tilla, konstatim i mbështetur në përfundimet e ekspertëve, të cilët kanë konkluduar se sjellja e të gjykuarit nuk ka qenë në përputhje me rregullat e profesionit dhe standardet mjekësore të zbatueshme. Për sa i përket individualizimit të dënimit, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kanë bërë një analizë të plotë dhe të balancuar të kritereve të parashikuara në nenin 47 dhe vijues të KP-së, duke marrë në konsideratë shkallën dhe formën e fajit, rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe të autorit, rrethanat e kryerjes së veprës, faktin që i

gjykuari nuk ka precedentë penalë, nivelin arsimor dhe kushtet ekonomiko-familjare, duke arritur në përfundimin se aplikimi i dënimit alternativ, sipas nenit 59 të KP-së, është i përshtatshëm dhe proporcional me rrethanat e çështjes. Gjithashtu, Gjykata e Lartë e çmon të drejtë vlerësimin e gjykatës së apelit se në rastin konkret plotësohen edhe kushtet ligjore për aplikimin e nenit 63 të KP-së, duke pasur parasysh rrezikshmërinë e ulët shoqërore të kërkuesit, mungesën e dënimeve të mëparshme dhe faktin se personaliteti dhe gjendja e tij gjyqësore nuk tregojnë një tendencë të qëndrueshme për shkeljen e ligjit penal. Në këto kushte, sipas Gjykatës së Lartë, qëllimi i dënimit mund të arrihet edhe pa izolimin e tij fizik, përmes masave alternative që synojnë riedukimin dhe rehabilitimin e autorit. Për sa u përket pretendimeve të rekursit që lidhen me vlerësimin e provave dhe konkluzionet faktike të gjykatave më të ulëta, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se ato dalin jashtë juridiksionit ekskluzivisht ligjor të saj, pasi çështjet e provave janë shqyrtuar tashmë nga gjykatat e faktit në përputhje me nenin 152 të Kodit të Procedurës Penale *(KPP).*

12. Në datën 14.05.2026, nëpërmjet shërbimit postar, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar më 26.05.2026.

II

Pretendimet e kërkuesit

13. ***Kërkuesi,*** në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

13.1.*E drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor,* pasi gjykata e apelit, pavarësisht pretendimeve të shumta të ngritura në ankim nga kërkuesi, është mjaftuar me një paragraf arsyetimi, pa argumentuar në asnjë rresht përgjegjësinë penale të tij. Po kështu, Gjykata e Lartë nuk ka marrë në analizë asnjë prej pretendimeve të kërkuesit lidhur me pafajësinë e tij referuar të gjitha akteve të administruara në gjykim, nga ku është evidentuar se dëmi i ardhur fëmijës është shkaktuar nga SBA-ja që nuk lidhet me veprimet ose mosveprimet e kërkuesit. Nuk mund të përcaktohet momenti i saktë i kësaj sëmundjeje, sikurse është konfirmuar nga pjesa më e madhe e ekspertëve, të cilët kanë vlerësuar se edhe nëse do të ishte konstatuar, dëmtimi nuk mund të ishte evituar për shkak se ndërhyrja me fotoskopi me laser nuk kryhet në Shqipëri, çka do të thotë se pasoja ishte në çdo rast e pashmangshme. Nga ekspertët

mjeko-ligjorë nuk është evidentuar në asnjë moment ndonjë veprim i pakujdesshëm ose mosveprim i kërkuesit që ka sjellë përfundimin e nxjerrë nga gjykatat për mjekim të pakujdesshëm. Gjithashtu, në analizën e 2 profesionistëve të fushës obstetrike gjinekologjike është vërtetuar se nga pamjet ekografike deri në javën e 27-të të shtatzënisë nuk vihen re anomali dhe protokolli mjekësor është respektuar duke kryer jo 3 ose 4 ekografi, por 8 të tilla. Vepra penale "Mjekimi i pakujdesshëm", i parashikuar nga neni 96, paragrafi 1, i KP-së nuk mund të garantojë mbrojtje për fetusin brenda nënës, për rrjedhojë nuk mund të jetë viktimë e veprës penale.

13.2.*E drejta për të mos u dënuar pa ligj*, e garantuar nga neni 29, pika 1, i Kushtetutës, pasi kërkuesi nuk plotëson tre elementet e veprës penale "Neglizhenca në trajtimin mjekësor", atë objektiv (mungesën e lidhjes shkakësore midis veprimit/mosveprimit dhe pasojës), atë subjektiv (mungesa e fajit, pasi pasoja nuk ka qenë e mundur të parashikohet) dhe atë subjektiv pasiv (pasi fetusi nuk mund të jetë subjekt i veprës penale), për rrjedhojë nuk duhej dënuar penalisht.

13.3.*Parimi i fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues*, i garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, i garantuar nga neni 29 i Kushtetutës, pasi në rastin konkret duhet të ishte zbatuar dispozita më favorizuese që është neni 96, paragrafi 1, i KP-së pas ndryshimeve me ligjin nr.44, datë 18.07.2019 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" (*ligji nr.44/2019*), duke e titulluar këtë vepër penale si "Neglizhenca në trajtimin mjekësor".

13.4. *Parimi i prezumimit të pafajësisë,* i garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, pasi gjykata e apelit nuk ka analizuar nëse prokuroria, mbi të cilën rëndon barra e provës, ka provuar se kërkuesi ka konsumuar plotësisht të gjitha elementet e veprës penale. Ndonëse kërkuesi i ka ngritur këto pretendime edhe në rekurs, Gjykata e Lartë është mjaftuar me qasjen e përgjithshme formaliste të gjykatës së apelit se kjo e fundit ka bërë vlerësim të drejtë të provave dhe interpretim të saktë të ligjit. Si prokuroria, ashtu edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e kanë nisur procesin me prezumimin se kërkuesi nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej dhe vendimet e gjykatave të faktit dëshmojnë se fajësia e tij nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka luajtur një rol aktiv në garantimin e standardeve kushtetuese.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për kriteret e pranueshmërisë së kërkesës

14. Çështja e legjitimimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja "f", dhe 134, pikat 1, shkronja "i", dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë edhe kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të shkronjës "f" të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës "i" të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në çështjen objekt të ankimit kushtetues individual, për rrjedhojë ka interes të drejtpërdrejtë për vënien në lëvizje të këtij gjykimi. Po kështu, ai plotëson edhe kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, pasi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm dhe pasi ka shteruar në formë e në substancë mjetet e zakonshme të ankimit ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë është i datës 06.11.2025 dhe i është komunikuar kërkuesit nëpërmjet postës elektronike në datën 14.01.2026, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në datën 14.05.2026, pra brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja "b", i Ligjit Organik të Gjykatës.

16. Për sa i përket legjitimimit *ratione materiae*, Kolegji vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, së drejtës për të mos u dënuar pa ligj, parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, si dhe parimit të prezumimit të pafajësisë.

17. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues, të garantuar nga neni 29, pika 3, i Kushtetutës, me pretendimin se në rastin konkret duhej të ishte zbatuar dispozita më favorizuese që është neni 96, paragrafi 1, i KP-së pas ndryshimeve me ligjin nr.44/2019, duke e titulluar këtë vepër penale si "Neglizhenca në trajtimin mjekësor".

18. Në lidhje me zbatimin e ligjit favorizues, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se neni 29 i Kushtetutës në pikën 3 parashikon se ligji penal favorizues ka fuqi prapavepruese. Gjykata është shprehur se e drejta e përfitimit nga efekti prapaveprues i ligjit penal favorizues, e sanksionuar në nenin 29, pika 3, të Kushtetutës, ka të bëjë me thelbin e një procesi të drejtë penal dhe, si e tillë, është e rëndësishme për respektimin e së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor. Ky parim gjen zbatim vetëm për ligjet penale, arsye për të cilën dispozita kushtetuese reflektohet në nenin 3 të KP-së, sipas të cilit kur ligji i kohës kur është kryer vepra penale dhe ligji i mëvonshëm janë të ndryshëm, zbatohet ai ligj, dispozitat e të cilit janë më të favorshme për personin që ka kryer veprën penale (*shih vendimet nr. 2, datë 15.02.2017; nr. 1, datë 20.01.2014; nr. 14, datë 17.04.2007 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas Gjykatës dënimi penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, nga njëra anë, dhe shkallës së fajit të autorit të saj, nga ana tjetër. Në këtë drejtim, përcaktimi i veprave penale dhe i llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila duke shqyrtuar të gjitha elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale (*shih vendimet nr. 9, datë 26.02.2016; nr. 12, datë 19.03.2015; nr. 47, datë 27.06.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Po kështu, në jurisprudencën kushtetuese është theksuar vazhdimisht se sqarimi i kuptimit ose interpretimi i çdo dispozite ligjore të zbatueshme gjatë shqyrtimit të një çështjeje të caktuar është në kompetencë të gjykatave të sistemit të zakonshëm gjyqësor dhe se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, interpretimi i ligjit material ose procedural është detyrë e Gjykatës së Lartë. Gjykata ndërhyn vetëm atëherë kur, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm cenojnë parimet, standardet ose të drejtat kushtetuese *(shih vendimin nr. 19, datë 07.07.2022 të Gjykatës Kushtetuese)*.

20. Për sa më sipër, Kolegji vëren se në kohën e kryerjes së veprës penale, neni 96 i KP-së titullohej "Mjekimi i pakujdesshëm" dhe paragrafi 1 i tij parashikonte dënimin me gjobë ose me

burgim “deri në pesë vjet”, ndërsa me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 44/2019, është ndryshuar titulli i nenit në “Neglizhenca në trajtimin mjekësor”, duke parashikuar në paragrafin 1 të tij dënimin me gjobë ose me burgim “deri në një vit”, pra duke ulur kufirin maksimal të dënueshmërisë së kësaj vepre “nga pesë vjet deri në një vit” burgim.

21. Po kështu, në zgjidhjen e çështjes konkrete, gjykata e shkallës së parë e ka deklaruar fajtor kërkuesin për kryerjen e veprës penale “Mjekimi i pakujdesshëm”, të parashikuar nga neni 96, paragrafi 1, i KP-së, duke e dënuar me 10 (dhjetë) muaj burgim dhe ky dënim është pezulluar, bazuar në nenet 59 dhe 61 të KP-së, me kusht që kërkuesi i pandehur gjatë kohës së provës të mos kryejë vepër tjetër penale dhe të mbajë kontakte me shërbimin e provës, duke i ndaluar njëkohësisht edhe ushtrimin e veprimtarinë profesionale si mjek obstetër gjinekolog, gjatë kohës së provës prej një viti e tetë muajsh, bazuar në nenin 60/5 të KP-së. Ndërkohë gjykata e apelit ka vendosur pezullimin e vendimit me burgim për kërkuesin dhe zëvendësimin e tij me detyrimin për të kryer 40 orë pune në interes publik, që do të përcaktohet nga shërbimin i provës si dhe heqjen e dënimit plotësues të parashikuar nga neni 50/5 i KP-së për mosushtrimin e profesionit. Lidhur me pretendimin e kërkuesit për moszbatim të ligjit penal më favorizues, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ndonëse ka evidentuar se neni 96, paragrafi 1 i KP-së i kohës së kryerjes së veprës penale nga kërkuesi dhe i njëjti nen në fuqi në kohën e gjykimit në apel dhe në Gjykatën e Lartë, ishin të ndryshëm, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit që edhe pse i ka bërë referim nenit 96, paragrafi 1 të KP-së para ndryshimit me ligjin nr.44/2019, e ka reduktuar masën e dënimit në detyrimin për të kryer 40 orë pune me interes publik.

22. Për sa më sipër, Kolegji konstaton se gjykatat e faktit në dënimin e kërkuesit, ndonëse janë bazuar në nenin 96, paragrafi 1, të KP-së, përpara ndryshimeve më favorizuese të këtij neni me ligjin nr.44/2019, kanë zbatuar një dënim më të lehtë, duke e dënuar fillimisht atë me 10 muaj burgim (dënimi është brenda kufirit maksimal të parashikuar nga ligji penal më favorizues), të pezulluar për një periudhe kohe prej një viti e tetë muajsh, duke i ndaluar ushtrimin e profesionit për këtë periudhë kohe, duke i caktuar në përfundim një dënim alternativ me 40 orë pune me interes publik. Në këtë drejtim, duke pasur parasysh edhe jurisprudencën e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë *(shih vendimin nr. 00-2023-183, datë 31.01.2023),* sipas së cilës dënimi quhet i përshtatshëm për sa kohë që nuk e kalon limitin e parashikuar të dënimit në ligjin penal favorizues, Kolegji vlerëson se mosreferimi nga gjykatat e faktit në dispozitën e kohës së gjykimit për veprën penale

nuk ka sjellë pasoja në të drejtat e kërkuesit. Për rrjedhojë, pretendimi i tij për cenimin e parimit të fuqisë prapavepruese të ligjit penal favorizues është haptazi i pabazuar.

23. Lidhur me pretendimet e tjera të kërkuesit, nisur nga thelbi i tyre, Kolegji vëren se ato janë të ndërthurura me pretendimin për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë,* pasi, sipas kërkuesit, vendimet e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm janë marrë në shkelje të parimeve kushtetuese të procesit gjyqësor penal, si prezumimi i pafajësisë, dyshimet janë në favor të të pandehurit, si dhe vendimi i fajësisë jepet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Për këtë qëllim, Kolegji vlerëson t'i analizojë pretendimet në këndvështrim të *parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor,* të garantuara nga nenet 30, 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës.

B. Për pretendimin e cenimit të parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor

24. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se gjykata e apelit nuk ka analizuar nëse prokuroria mbi të cilën rëndon barra e provës ka provuar plotësimin e tre elementeve të veprës penale "Neglizhenca në trajtimin mjekësor", atë objektiv (mungesën e lidhjes shkakësore midis veprimit/mosveprimit dhe pasojës), atë subjektiv (mungesa e fajit, pasi pasoja nuk ka qenë e mundur të parashikohet) dhe atë subjektiv pasiv (pasi fetusi nuk mund të jetë subjekt i veprës penale), për dënimin e tij. Sipas kërkuesit, si prokuroria, ashtu edhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk e kanë nisur procesin me prezumimin se ai nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohej dhe vendimet e gjykatave të faktit dëshmojnë se fajësia e tij nuk është provuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka luajtur një rol aktiv në garantimin e standardeve kushtetuese. Po kështu, sipas kërkuesit, gjykata e apelit, pavarësisht pretendimeve të shumta të ngritura në ankim prej tij, është mjaftuar me një paragraf arsyetimi, pa argumentuar në asnjë rresht përgjegjësinë penale të tij, ndërsa Gjykata e Lartë nuk ka marrë në analizë asnjë prej pretendimeve të kërkuesit lidhur me pafajësinë e tij referuar të gjitha akteve të administruara në gjykim, nga ku është evidentuar se dëmi i ardhur fëmijës është shkaktuar nga sëmundja e bandës amniotike që nuk lidhet me veprimet ose mosveprimet e kërkuesit, sikurse është konfirmuar nga pjesa më e madhe e ekspertëve.

25. Kushtetuta në nenin 30 të saj përcakton se kushdo quhet i pafajshëm përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Ky parim kushtetues ka gjetur pasqyrim edhe në nenin 4 të KPP-së, i cili përcakton gjithashtu se çdo dyshim për akuzën çmohet në favor të të pandehurit. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se sipas këtij parimi, në gjykimin penal, barra e provës i takon palës akuzuese, çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit dhe gjykatat e zakonshme duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta (*shih vendimet nr. 63, datë 20.11.2023; nr. 10, datë 12.04.2022; nr. 68, datë 14.11.2016 të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas këtij parimi, asnjë dënim penal nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 8, datë 20.02.2024; nr. 12, datë 24.04.2018 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Gjykata ka pohuar se për të vlerësuar nëse ka pasur ose jo cenim të të drejtave kushtetuese, ajo i referohet arsyetimit të vendimeve të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se, bazuar në parimin e subsidiaritetit, ajo (Gjykata) është mjeti i fundit për mbrojtjen e këtyre të drejtave (*shih vendimet nr. 79, datë 12.11.2024; nr. 29, datë 16.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata është shprehur gjithashtu se ajo nuk vepron si shkallë e katërt gjykimi, por ndërhyn në rastin kur gabimi ligjor ose faktik nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm është aq i dukshëm, sa një gjykatë e kujdesshme nuk mund ta kishte bërë ndonjëherë ose i tillë që gjykimin e bën thellësisht të padrejtë (*shih vendimet nr. 14, datë 07.03.2024; nr. 9, datë 27.02.2024; nr. 33, datë 14.11.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Mbi bazën e këtyre standardeve, sikurse u parashtrua në rrethanat e çështjes, Kolegji vëren se gjykata e shkallës së parë, fillimisht ka identifikuar provat, prej të cilave ka nxjerrë përfundimin për fajësinë dhe dënimin e kërkuesit. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, ajo gjykatë ka arsyetuar se vepra penale është kryer me faj në formën e neglizhencës, pasi, sikurse ka konkluduar shumica e ekspertëve mjeko-ligjorë, kërkuesi duhej dhe ka pasur mundësi të konstatonte diagnozën, të njoftonte për të prindërit e fëmijës, në mënyrë që ata të vendosnin për sa i përket mundësisë së eliminimit të pasojës së rëndë shëndetësore te fëmija i lindur, por në mënyrë të pakujdesshme, jo vetëm nuk ka evidentuar diagnozën, por nuk ka konstatuar as mungesën pjesërisht të gjymtyrës së fetusit, duke plotësuar të gjitha elementet e veprës penale për të cilën është dënuar. Vendimi i gjykatës së shkallës së parë është lënë në fuqi nga gjykata e apelit me të njëjtin arsyetim, duke theksuar se është pikërisht mungesa e kujdesit që duhet të tregonte kërkuesi

në ushtrimin e detyrës së mjekut që e ngarkon me përgjegjësi penale. Ndërsa Gjykata e Lartë ka vlerësuar se cilësimi ligjor i faktit penal që i atribuohet kërkuesit, provueshmëria dhe masa e dënimit të caktuar ndaj tij nga gjykata e apelit, janë marrë në përputhje me ligjin penal material dhe procedural. Sipas saj, gjykata e apelit, në analizë të fakteve, ka konkluduar se kërkuesi, në cilësinë e mjekut obstetër-gjinekolog, pasi ka kryer ekzaminime me ultratinguj gjatë shtatzënisë, por pa evidentuar një anomali të rëndë të fetusit, si amputimi i njërit prej parakrahëve, kishte një detyrim profesional të shtuar për të ushtruar kujdesin e kërkuar nga standardet e profesionit të tij, duke qenë se aktiviteti i tij lidhet drejtpërdrejt me shëndetin dhe jetën e njeriut, ndaj mosidentifikimi i një anomalie të tillë përbën shkelje të këtij detyrimi dhe ka sjellë pasoja të rënda për viktimën dhe familjarët e saj. Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vepra penale është kryer me faj në formën e pakujdesisë, pasi kërkuesi nuk ka treguar nivelin e kujdesit profesional që kërkohet nga një mjek specialist në rrethana të tilla, konstatim i mbështetur në përfundimet e ekspertëve, të cilët kanë konkluduar se sjellja e të gjykuarit nuk ka qenë në përputhje me rregullat e profesionit dhe standardet mjekësore të zbatueshme

28. Për sa më lart, Kolegji vlerëson se dukshëm nuk rezulton që gjykatat e juridiksionit të zakonshëm të kenë përmbysur barrën e provës, duke ia kaluar atë kërkuesit. Ato kanë arsyetuar qartësisht për fajësinë e tij, mbështetur në prova të tilla, si aktet e ekspertimit dhe ekzaminimet periodike me ultratinguj, të cilat kanë evidentuar qartë mungesën e kujdesit profesional të kërkuesit në ushtrimin e detyrës së tij, duke pasjellë pasoja të rënda për shëndetin e fëmijës, prova këto që mbështesnin në harmoni me njëra-tjetrën akuzën në ngarkim të tij, përtej çdo dyshimi të arsyeshëm. Po kështu, nuk rezulton që arsyetimi i gjykatave për përcaktimin e fakteve të përmbajë gabime të dukshme, që ta bëjë vlerësimin e tyre të padrejtë në aspektin kushtetues. Për rrjedhojë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor* është haptazi i pabazuar.

29. Në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.